

**KONTRATE SHITBLERJE (KUOTASH)
BA-OIL SHPK L91401021P**



Ne Tirane, sot me date 06.02.2019 (dymije e nentembedhete), ne seline e Shoqerise BA-OIL SHPK ne Tirane, Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Kati 10, Ap.102 u paraqiten palet e meposhtme ku kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash si me poshte:

SHITESI:

Z. Irdi Dashnor Hoxhaj i dtl. 21.11.1992, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. 033176062 dhe nr. Personal J21121054E (me poshte i quajtur "Shitesi")

BLERESI:

Z. Erjon Fatos Plasa, i dtl. 19.03.1977, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. 025737640 dhe nr. Personal H70319127K, (me poshte i quajtur "Bleresi");

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkerisht do t'u referohemi si "Palet". Te dyja palet duan te lidhin kete marreveshje per Shit-Blerjen e 100% te Kuotave te Shoqerise BA-OIL SHPK si me poshte vijon:

Te pergjithshme

A. Shitesi eshte zoterues i 100% te kuotave ne Shoqerine "BA-OIL" SHPK (me poshte referuar si shoqeria). Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 01/02/2019, me numer NUIS **L91401021P**.

B. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit 100 % te kuotave qe zoteron ne kete shoqeri dhe Bleresi deshiron te bleje sipas kushteve te kesaj kontrate dhe pas kalimit te kuotave behet pronar ne masen 100% te shoqerise "BA-OIL" SHPK.

C. Ne perputhje me nenin 117 pika b "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave", te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise "Dispozitat e Pergjithshme per kontraten e shitjes", dhe ne pergjithesi te legjislacionit shqiptar ne fuqi, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon nepermjet shitblerjes se 100 % te kapitalit te zoteruar ne shoqeri si dhe te drejten e pronesise mbi 100% te kuotave dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje Bleresit, duke e garantuar plotesisht titullin e pronesise te pa renduar me barre dhe Bleresi nga ana tjeter blen nga Shitesi kuotat kundrejt nje cmimi te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1. Çmimi i plote i shitjes se kuotave eshte 100 (njqind) leke.

Neni 3

Pagesa

3.1. Çmimi eshte paguar nga bleresi te shitesi para nenshkrimt te kontrates.

Neni 4

Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat

4.1 Me nenshkrimin e kontrates ortakutaku i vetem i Shoqerise BA-OIL SHPK me NUIS **L91401021P** eshte Z. Erjon Plasa, Z. Irdi Hoxhaj nuk ka me asnje te drejte mbi kuotat e Shoqerise.

Erjon Plasa

4.2 Kalimi i pronesisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitesi të Bleresi do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitimin e kontratës në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Garancite

Shitesi në lidhje me kuotat që zoteron, garanton Bleresin:

5.1. Së është pronar i vetëm i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.

Neni 6

Regjistrimi

6.1. Regjistrimi i kalimit të kuotave nga Shitesi të Bleresi në Qendren Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 8

Ligji i zbatueshem

8.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendren Kombëtare të Biznesit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

9.1. Palet do të perpiqen të zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 10

Te ndryshme

10.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandare të kësaj kontrate.

10.2 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pelqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

10.3 Kjo kontratë u perpilua në 4 (kater) kopje me vlerë të barabartë ligjore.

Shitesi

Z. Irdi Hoxhaj

Irdi Hoxhaj


Bleresi

Z. Erjon Plasa

Erjon Plasa


